



Pranuar / Dorezuar Priljeno / Prodato Received / Delivered	02.02.2024	4 viti god veq	
Organ / Njësia Org. / Jednica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHCK	674/2024		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1559/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi -kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca - anëtar, me Ardita Perçuku-Shyti, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1559/2023, të datës 22.12.2023, të parashtruar nga ankuesja kundër Raportit të Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike i miratuar sipas Vendimit Nr.23/165 të datës 12.10.2023 të Qeverisë së Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.02.2024, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa A.nr.1559/2023 e datës 22.12.2023 e parashtruar nga ankuesja,

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, (tutje referuar ankuesja), më datë 22.12.2023, ka parashtruar ankesë, e regjistruar nën shenjën A.nr.1559/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me mos përfshirjen e pozitës si Zyrtare e Lartë e TI-së për Racionalizim të Proceseve Administrative në kategorinë e ekspertëve të definuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, përkatësisht Rregullores (QRK) Nr.11/2023 për Ekspertët në shtojcën 14.4, me pretendimet ankimore se edhe përkundër kërkesës së datës 24.03.2023 të dërguar nga Zv.Drejtori i ASHI-së lidhur me përfshirjen si tërësi për stafin e ASHI-së nga Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike, ky i fundit ka bërë ndarje për disa pozita në mesin e të cilave është edhe pozita si Zyrtare e Lartë e TI-së për Racionalizim të Proceseve Administrative/ASHI.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 04.01.2024, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike, ndërsa, ky i fundit, me datë 09.01.2024, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me provat materiale lidhur me këtë çështje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshilli) pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë ka konstatuar se ankesa e ankueses, *është e parakohshme, sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se Qeveria e Republikës së Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe Rregulloren (QRK) Nr.11/2023 për Ekspertët, me Vendimin Nr.07/132 të datës 08.03.2023, ka themeluar Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, përgjegjës për pranimin e kërkesave të dërguara nga institucionet dhe vlerësimin e tyre, si dhe dërgimin në Qeveri për aprovim të Listës së Eksperteve, të kategorizuar në shtojcën 14.4 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik. Si rrjedhojë, komisioni përkatës i themeluar nga Qeveria, ka përgatit Raportin e punës, Listën e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimeve me rëndësi strategjike dhe Listën e pozitave të Eksperteve sipas Shtojcës 14.4 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, të cilat janë miratuar nga Qeveria e Kosovës, me Vendimin Nr.23/165 të datës 12.10.2023.

Kundër Raportit të Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, i miratuar sipas Vendimit Nr.23/165 të datës 12.10.2023 të Qeverisë së Kosovës, ankuesja, me datë 22.12.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se edhe përkundër kërkesës së datës 24.03.2023 të dërguar nga Zv.Drejtori i ASHI-së lidhur me përfshirjen si tërësi për stafin e ASHI-së nga Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, ky i fundit ka bërë ndarje për disa pozita në mesin e të cilave është edhe pozita si Zyrtare e Lartë e TI-së për Racionalizëm të Proceeseve Administrative/ASHI.

Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimet ankimore të ankueses ka analizuar shkresat e lëndës dhe për rrjedhojë ka gjetur se organi përkatës i punësimit, gjegjësisht, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI), ka propozuar sistemet e saj për tu kategorizuar si Sisteme Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike dhe po ashtu pozitat e punës në kuadër të këtyre sistemeve për tu kategorizuar si ekspert sipas Shtojcës 14.4 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa Komisioni përkatës i themeluar nga Qeveria, ka njohur si Sisteme Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, në kuadër të ASHI-së, vetëm këto sisteme: *Sistemin e Informacionit për siguri kibernetike qeveritare; Sistemin e Informacionit në qendrën shtetërore të të dhënave; Platforma e Kosova; Platforma e Interoperabilitetit-GG; Sistemi i telefonisë dhe rrjetit kompjuterik shtetëror; Infrastruktura për hosting të aplikacioneve dhe data baza përkatëse e IRK-se në platformën Microsoft; Infrastruktura për hosting të aplikacioneve dhe data baza përkatëse e IRK-se në platformën Open Source; Sistemi elektronik për menaxhimin e pasurisë shtetërore e Pasuria; Sistemi i Internetit të Komunave (SIK); Sistemi për Menaxhimin dhe Arkivimin Elektronik të Dokumenteve-SMAED; Sistemi i menaxhimit të vijueshmërisë në punë (SMVP); Sistemi elektronik i kartelave identifikuese, dhe rrjedhimisht në kuadër të këtyre sistemeve ka njohur njëzetetë (23) pozita të punës për Ekspert sipas Shtojcës 14.4 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.*

Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, në përgjigjen e dhënë si në ankesë, ka njoftuar se me datë 06.12.2023 ka pranuar kërkesë nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, për rishikim të listës se pozitave të ekspertëve dhe se shqyrtimi i kërkesave për rivlerësim është duke vazhduar.

Andaj, duke marrë parasysh faktin se organi i punësimit, gjegjësisht, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, me datë 06.12.2023 ka parashtruar kërkesë për rishikim të listës së pozitave të ekspertëve tek Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankueses e parashtruar me datë 22.12.2023 në

Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ende pa kaluar afatit për vendosje në raport me kërkesën e datës 06.12.2023 është parakohshme në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 98 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj, ngase nuk ka kaluar afati i përcaktuar prej 45 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim nga organi përkatës i punësimit, dhe si e tillë ankesa vlerësohet e papranueshme në kuptim të nenit 127 paragrafit 4 ndërlidhur me nenin 129 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

Kështu që për sa më sipër e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1559/2023

Ardita Perçuku-Shyti

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Dëmi
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses,
- Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit më Rëndësi Strategjike;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

